



**NEON A.S**  
RR.XHANFISE KEKO, Nd.168 , H.1, CP. 1005  
TIRANA, ALBANIA  
TEL: +355 42 377 773 FAX:: +355 42 347 770  
E-MAIL: [info@neon.al](mailto:info@neon.al) WEB: [www.neon.al](http://www.neon.al)

---

**NEON TOP ACRYLIC PAINT  
( TOP AKRELIK )  
BOJE PËR LYERJE MURI  
Skedë Teknike**

---

**PËRSHKRIMI:** TOP ACRYLIC PAINT është një bojë e bardhë e pregatitur nga një emulsion i tipit “polimer në ujë” e destinuar për lyerjen e fasadave të jashtme, që përveç rezinave akrilike dhe ujit përmban në përqindje të caktuara mbushës, pigmente e shtesa të tjera sikurse janë dioksid titani, talk, karbonat kalciumi, heksametafosfat natriumi, hidroksietilcelulozë, izotiazolinon, poliksiloksane, poliakrilat amoni, hidroksid kaliumi, të cilët përmirësojnë vetitë e bojës. Referuar përbërësve të saj, boja thahet 3 - 4 orë pas aplikimit, duke formuar një mbulesë të rrafshët fleksibël, e cila ka rezistencë të mirë ndaj fërkimit dhe qëndrueshmëri të mirë ndaj kushteve klimaterike.

**FUSHA E PËRDORIMIT:** TOP ACRYLIC PAINT është e përdorshme në mjedise të brendëshme (mure,tavane , për bojatisjen e sipërfaqeve të suvatuara ose sipërfaqeve prej betoni.

**NGJYRA:** E bardhë.

**PARAPËRGATITJA:** Sipërfaqja që do të bojatiset, duhet të pastrohet nga pluhurat, yndyrnat apo nga shtresa të mëparshme të bojës, të lidhura dobët me sipërfaqet (shtresat e fryra). Rekomandohet paraprakisht lyerja me astar AN – 501 me bazë uji ose me astar NEON DUR me bazë WHITE SPIRIT.

**PËRDORIMI:** Përgatitet boja duke i shtuar ujë deri në konsistencën e kërkuar. Për të realizuar një lyerje të mirë, duhet të aplikohen dy duar TOP ACRYLIC PAINT. Doza e pigmentit që mund të përdoret, është sipas rekomandimit të prodhuesit. Për dorën e parë hollimi i bojës me ujë duhet të jetë në masën 15 - 20%. Ndërsa për dorën e dytë në masën 10%. Lyerja aplikohet lehtësisht me rrul ose furçë.

**NGJYRIMI:** TOP ACRYLIC PAINT është e përshtatshme për të krijuar një gamë të gjërë bojrash me ngjyrë, duke përdorur 9 bazat ngjyruese NEON UNO COLOR PAINT dhe 9 bazat ngjyruese NEON RS COLOR PAINT, si dhe ngjyrimin nëpërmjet dozimit sipas sistemeve kompjuterike me 16 ngjyra.

**KUJDES:** Nuk lejohet aplikimi i bojës në sipërfaqe të njoma dhe në kushte të larta lagështie të mjedisit. Nuk rekomandohet përdorimi i bojës në temperaturë më të vogël se 5°C. Pas përfundimit të lyerjes paisjet duhet të lahen menjëherë me ujë dhe sapun.

**TE DHENAT TEKNIKE:**

- Ngjyra.....E bardhë
- Imtësia.....20 – 45  $\mu\text{m}$
- Viskoziteti ( 30% ujë) Deep Cup 4.....23 – 28 sek
- Densiteti.....1.4 – 1.42 g/ml
- Fuqia mbuluese për lyerje të plotë.....5 – 6  $\text{m}^2/\text{L}$
- Mbetja e thatë..... $\leq 51 \%$
- Koha e tharjes.....3 - 4 orë

**REZIKSHMËRIA:** Bojrat me bazë ujore të “NEON sh.a” kanë përbërës që nuk klasifikohen si të rrezikshëm mbështetur në Direktivën 1999/45/EC. Megjithatë kontakti me acidet dhe në temperatura mbi 800<sup>0</sup>C, bën që të çlirohet dioksid karboni.

**AMBALAZHIMI:** Ambalazhimi bëhet në kova plastike 3L, 9L dhe 15L.

**KUSHTET E RUAJTJES:** Në ambalazh të mbyllur hermetikisht, të mbrojtur nga ngrica.